



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 931/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gillogjani anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruar nga Faruk Guri, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me shenjë ZL.Anr.931/2017, ZL.Anr.932/2017, ZL.Anr.933/2017, ZL.Anr.934/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj në Vendvotimet: 2504D/03D, 2527D/01R, 2502D/06R, 2521/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar apelet ZL.Anr.931/2017, ZL.Anr.932/2017, ZL.Anr.933/2017 dhe ZL.Anr.934/2017 me datë 10.11.2017, nga parashtruesi i apeleve Faruk Guri, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, pretendon se ka mospërputhje të rezultateve nga rezultati i rinumërimit me formularin e rezultateve të kandidatëve të KKZ. Parashtruesi i apelit pretendon se në vendvotimin 2504D/03D sipas rinumërimit ka 7 vota, ndërsa sipas listës së rezultateve të kandidatëve të shpallura nga KKZ-ja ka 15 vota, në

vendvotimin 2527D/01R sipas formularit të rezultateve nuk ka asnjë votë, por sipas formularit të vëzhguesve ka 3 vota, në vendvotimin 2502D/06R sipas rezultatit të rinumërimit ka vetëm 2 vota ndërsa sipas rezultateve të shpallura nga KKZ ka 11 vota, në vendvotimin 2521/01R sipas rinumërimit nuk ka asnjë votë ndërsa sipas rezultateve të kandidatëve të shpallura nga KKZ-ja ka 8 vota. Në mbështetje të pretendimeve të parashtruar në apele ka bashkangjitur formularët e rinumërimit, formularët e KKZ-së si dhe formularin e vëzhguesve.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.931/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet e parashtruara në apele janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në vendvotimet e cekura më lartë në pjesën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.931/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim